

21.03.2023

02-162

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E SHTIMES/OPSTINA ŠTIMLJE	
Nr i Proq/Br. Prot. <u>02/24</u>	
Nr i Faqeve/Bri.strana	
Data/Dana: <u>21.03.2023</u>	
SHTIME/ŠTIMLJE	

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISE-MINISTERSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësie Org. Org.Jednica Org Unit <u>04</u>	Nr.Prot: Ergj Prot Prot.No: <u>05-1622</u>
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages <u>-5-</u>	Data: Datum: <u>15.03.2023</u>
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministerstvo Zdravstva – Ministry of Health



Komuna Shtime-Opština Štimlje-Municipality of Shtime

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

DHE

KOMUNËS SHTIME

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

"NDËRTIMI I OBJEKSTIT TË RI TË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË
FAMILJARE NË SHTIME"

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, e përfaqësuar nga z. Arben Vitia Ministër (në tekstin e mëtejmë Ministria)

KOMUNA SHTIME, e përfaqësuar nga z. Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna)

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i obligimeve të përbashkëta institucionale duke përfshirë mbështetjen financiare të cilat palët do t'i përbushin në funksion të realizimit të projektit: "Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Shtime".

Realizimi i Projektit për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Shtime i konceptuar duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës, është në përputhje me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor në njëren anë, si dhe në funksion të ushtrimit të suksesshëm të përgjegjësive të Komunës të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisje lokale përkitazi me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në nivelin primar.

II OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët, në funksion të realizimi të qëllimit të përcaktuar në nenin një (1) të këtij Memorandumi i marrin përsipër këto obligime të përbashkëta:

- 1.1. Sigurojnë realizimin e suksesshëm të projektit dhe përbushjen e qëllimit të këtij memorandumi;
- 1.2. Inkorporojnë në projekt, të tjera komponentë apo /dhe ndryshime që mund të përcaktohen dhe që paraprakisht duhet te shqyrtohen dhe miratohen nga palët nënshkruese të këtij memorandumi;
- 1.3. Udhëheqin në bashkëpunim procesin e shpenzimit të buxhetit sipas miratimit paraprak dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
- 1.5.Sigurojnë përfundimin, përkatësisht realizimin e projektit, si në nenin l, të këtij Memorandumi, jo më larg se viti 2025.

III

OBLIGIMET E PALËVE

1. MINISTRIA E SHËNDETËSISË:

- 1.1. Mbështet realizimin e projektit përmes investimit finanziar në shumën prej 1, 250, 000. 00 Euro.
- 1.2. Mbështetja buxhetore nga MSh për projektin e përshkruar si më lartë, përkizati me planifikimet vjetore buxhetore, shtrihet në vitet 2023, 2024 dhe 2025 në përputhje me parashikimet e përcaktuara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve;
- 1.3. Emëron një anëtar në Komisionin përkatës për vlerësimin e ofertave gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes të operatorit ekonomik
- 1.4. Mjetet financiare në vlerë si në pikën më lartë, MSh i realizon sipas dokumentacionit përkatës për secilën fazë të ndërtimit të objektit në bazë të faturimit që e sjell Komuna.
- 1.5. Në bashkëpunim me Komunën, kujdeset për realizimin e suksesshëm të gjithë projektit përmes ofrimit të asistencës profesionale, administrative dhe teknike që mund të jetë e nevojshme dhe që është në përgjegjësinë dhe mandatin e saj;
- 1.6. Cakton (zgjedhe) organin mbikëqyrës, i cili vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik, lëshon dokumentin finanziar me kërkesë për pagimin e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës pas verifikimit të berë nga Komuna.
- 1.7. Cakton një anëtar të Komisionit për Pranim teknik të objektit;

2. KOMUNA E SHTIMËS

- 2.1 Merr përsipër hartimin e projektit detal, paramasa dhe para llogaria të jenë konform kritereve te legjislacionit në fuqi duke krahasuar çmimet e tregut sipas Ligjit të Prokurimit Publik,
- 2.2 .Merr përsipër zhvillimin e procedurave përkatëse të prokurimit për realizimin e projektit, përkatësisht arritjen e qëllimit të këtij memorandumi.
- 2.3. Emëron menaxherin e kontratës në funksion të realizimit me sukses të kontratës për ndërtim të objektit së bashku me detyrat dhe përgjegjësit e tij konform dispozitave ligjore në fuqi
- 2.4. Mban të drejtën e verifikimeve teknike dhe financiare te projektit gjatë realizimit, në formën e kolaudimeve, nëse për ketë e konsideron te nevojshme në funksion të

shfrytëzimit sa më racional të mjeteve financiare dhe në funksion të realizimit të suksesshëm te projektit

2.5.Komuna merr përsipër të formoj komisionin për pranim teknik të objektit.

IV ZBATIMI

MSh dhe Komuna, përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime që duhet të ndërmerrën në përbushjen e obligimeve të përcaktuara në ketë Memorandum.

V PLOTËSIM NDRYSHIMI APO SHKËPUTJA EVENTUALE E MEMORANDUMIT

1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;
2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë mbinatyrore -palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me njëra-tjetrën për veprimet që duhet të ndërmerrën;
3. Afati i realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi duhet të arrihet jo më larg se viti 2025;
4. Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshohet apo plotësohet sipas një aneks marrëveshje me shkrim midis palëve;
5. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Marrëveshje Bashkëpuni, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Marrëveshje Bashkëpuni në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Marrëveshje Bashkëpuni, të akorduar nga palët e kësaj marrëveshje, do të konsiderohen si të integruar në këtë dokument.

VI ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiken që mosmarrëveshjet zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tillë.

VII

NËNSHKRIMI 1 MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është i hartuar në katër (4) kopje identike origjinale, nga dy (2) për palët nënshkruese.

VIII HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.



Ministër i Shëndetësisë



Kryetar i Komunës se Shtimes

Prishtinë: 15, Mars 2023